

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Gjuetia" e mediave angleze ndaj shqiptarëve, ambasadori Uran Ferizi ankesë zyrtare pranë Rregullatori t të Medias në Britani: Po paragjykohet një komunitet i tërë
ADRESA	https://www.gazetatema.net/kronika/gjuetia-e-mediave-angleze-ndaj-shqiptareve-ambasadori-uran-ferizi-ankese-i585591
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	12 shtator 2026, 11:25:46 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	12 shtator 2026, 12:50:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a9be706708bab030758b4a47b930adee7377c07838271d08adfbff35e7894454
TEKSTI	dab78a55ba54a119ade76d22663c9dcd275dc5eb94458472503a22daffff9b01
PAMJA	b81ebd8376a1c8141f726f2051d3ef6a61e20dd138ab62883a9dfa9b4c7035fe

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	7761271d2b78d014f09fa2d0647296b1188473fe626108af627d46ba856b65ba
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/7761271d2b78d014f09fa2d0647296b1188473fe626108af627d46ba856b65ba>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by
[Kontakt](#)

English

1e Trump takohet me lideret irlandezë, protesta kundër luftës në Iran“Drejtësia po godet rendin kushtetues”. Çupi: Gjyqësori në Shqipëri është mësuar me para në xhepNis sezoni i ri në TKOBShB? fundit

"Gjuetia" e mediave angleze ndaj shqiptarëve, ambasadori Uran Ferizi ankesë zyrtare pranë Rregullatorit të Medias në Britani: Po paragjykohet një komunitet i tërë

12 Shtator 2026, 14:50Kronika TEMA



"Gjuetia" e mediave angleze ndaj shqiptarëve, ambasadori Uran

Ambasadori i Shqipërisë në Britaninë e Madhe, diplomati Uran Ferizi njoftohet se ka depozituar një ankesë zyrtare pranë Rregullatorit të Medias në Angli, në lidhje me një reportazh të medias së njohur "Sky News".

Sipas tij, reportazhi që ngre paragjykime mbi komunitetin shqiptar në Angli, është i njëanshëm dhe i papërgjegjshëm, ndaj diplomati ynë Uran Ferizi i është drejtuar fillimisht televizionit dhe më pas ka vënë në lëvizje Rregullatorin e medias.

"Në vijim të reportazhit të njëanshëm dhe të papërgjegjshëm të Sky Nwës, 6-7 gusht, mbi shqiptarët dhe komunikimit të zhvilluar me drejtuesit e këtij kanali, sot Ambasada e Shqipërisë në Londër depozitoi një ankesë zyrtare pranë Ofcom, autoritetit rregullator britanik të medias.

Ankesa ngre shqetësime serioze për pasaktësi, mungesë konteksti dhe përgjithësime të pajustificuara, të cilat e lidhin identitetin shqiptar me kriminalitetin dhe, në vend që të informojnë me përgjegjësi, prezantojnë dhe përforcojnë stereotipe etnike ndaj shqiptarëve.

Liria e medias është themelore. Po aq themelor është detyrimi që ajo të jetë e saktë dhe të mos ushqejë paragjykime ndaj një komuniteti të tërë për veprimet e disa individëve", thuhet ndër të tjera në njoftimin e Ambasadës së Shqipërisë në Angli.

Në ankesën që ambasadori Uran Ferizi i ka dërguar së pari televizionit, ai thekson se ndërsa aktiviteti kriminal është qartësisht një temë legjitime për gazetarinë, formulimi i përgjithshëm i këtij raporti i lidh vazhdimisht shqiptarët si kombësi me krimin e organizuar, kontrabandën e njerëzve dhe tregtinë e drogës në Mbretërinë e Bashkuar.

Ai shton se reportazhi me temë "Nuk është asgjë, vëlla": Kontrabandistët shqiptarë tallen me kufijtë e Mbretërisë së Bashkuar për të nxitur tregtinë e drogës" (botuar rreth 6 gushtit 2026), rrezikon të përforcojë stereotipin e dëmshëm se kriminaliteti është disi karakteristikë e shqiptarëve, në vend të veprimeve të një numri të vogël individësh.

"Raportimi i përgjegjshëm duhet të dallojë qartë midis rrjeteve kriminale dhe një komuniteti të tërë kombëtar. Shumica dërrmuese e shqiptarëve që jetojnë në Mbretërinë e Bashkuar janë banorë që zbatojnë ligjin dhe kontribuojnë pozitivisht në shoqërinë britanike. Mbulimi që nuk arrin të bëjë këtë dallim kontribuon në paragjykime dhe dëmton raportimin e drejtë dhe të saktë", vijon ankesa e diplomatit shqiptar.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Angli - Ish-qendrën tregtare dy shqiptarë e kthejnë në “shtëpi bari”, policia i heq nga duart prodhimin me vlerë 1.3 milionë paundë](#)

12:50 Kronika

[“Po zbatohet ‘Smart City’, kemi vendosur kamera inteligjente”- Nisja e sezonit shkollor, Hita për sigurinë: Orë ndër](#)

12:30 Kronika

[Nga dënimi në Shqipëri te arratisja spektakolare në Greqi, kush është i burgosur shqiptar që i iku policisë greke](#)

12:00 Kronika

[Arrestohet në Athinë i shumëkërkuari shqiptar, Hita jep detajet](#)

11:50 Kronika

[Tronditet Kamza, shpërthim me tritol në derën e shtëpisë së një 36-vjeçari](#)

10:08 Kronika / 1 koment

[Atentati ndaj Agron Pukës në Rrilë, Gjykata shuan masat e arrestit për tre të dyshuarit](#)

09:40 Kronika / 1 koment

[Kapen në flagrancë tre persona në Fier, dyshohen për vjedhje banesash dhe posedim droge \(VIDEO\)](#)

09:20 Kronika

[Aksidenti në Porto Palermo, përmbysen automjeti! Tre persona të plagosur](#)

08:20 Kronika

[Zjarret/ Ministria e Mbrojtjes: Pesë vatra aktive, asnjë rrezik për zonat e banuara](#)

21:54 Kronika / 1 koment

[Operacioni misterioz në Greqi, kush është trafikanti i kokainës që u arrestua dhe kërkohet nga Shqipëria për vrasje?](#)

20:40 Kronika

Më të lexuarat

24 orët e fundit

Javën e fundit

PISA, hakmarrja europiane për mësueso-fobët shqiptarë

16:18 Politika / 48 komente

Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës investon 2 milionë euro ...

13:45 Sociale / 3 komente

"Në emrin tim flas vetëm unë"/ Rama për arrestimin e Agas...

22:46 Politika / 28 komente

Ullishtja kombëtare e pronësisë shqiptare

17:00 Editorial / 20 komente

"Për dosjet e qytetarëve vite pritje, për pagat e veta Gj...

16:23 Politika / 51 komente

Blog Tema

John Goci konkurren Donald Trump, sa do të shkojë ankandi?

11:40 Blog

Haga, midis maktheve dhe paranojave

21:25 Blog / 2 komente

Haga, midis maktheve dhe paranojave

21:00 Blog / 1 koment

Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Ju mund të çregjistroheni në çdo moment.

 Powered by Tomorrow.io

TemA është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, TemA është një nga gazetatat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.



Built and Monetized by

- [Politika](#)
 - [Kronika](#)
 - [Editorial](#)
 - [Blog](#)
 - [Bota](#)
 - [Sport](#)
 - [Shëndeti](#)
 - [Turizëm](#)
 - [Kontakt](#)
 - [Te dhënat personale](#)
 - [Cookies](#)
- [Sociale](#)
 - [Ekonomia](#)
 - [Antena](#)
 - [Rajoni](#)
 - [Kulturë](#)
 - [Lifestyle](#)
 - [Dossier](#)
 - [Hi-Tech](#)

Built and Monetized by